



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 883/2 prot.,

Datë 26.04.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*OLSP*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. *REF-63921-03-28-2023*, me objekt: “*Blerje gazoil*”, me fond limit 9.815.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A.
- Ankimues:** “*OLSP*” SHPK
Adresa: Fshati Grize. Rruga Fier-Patos, Banesa në KM 6 (OLSI SHPK), Patos, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A
Adresa: Rajoni Nr. 1, Rruga “Boris Plumbi”, Nr. 20 Korçë.

Në datën 25.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 883/2023 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3053, e operatorit ekonomik “*OLSP*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. *REF-63921-03-28-2023*, me objekt: “*Blerje gazoil*”, me fond limit 9.815.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*OLSP*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “OLSP” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 883 prot., datë 25.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- Lidhur me operatorin ekonomik “OLSI” Sh.p.k, mbështetur në nenin 92, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, si dhe në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, nenin 82, vendos që ofertuesi “OLSI” Sh.p.k të mos kualifikohet sepse : Oferta e “OLSI” Sh.p.k me marzh fitimi 16,2 lekë/litër është në kundërshtim me nenin 2 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar” , i cili përcakton marzhin e tregtimit me pakicë : 12 lekë/ litër. Referuar nenit 4 të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 25.3.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar”, si dhe Njoftimit të APP-së nr. 2060, datë 23.03.2022 , si anëtar i KVO-së mbaj në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar dhe për shkak se marzhi i fitimit i ofuar është më i lartë se kufiri 12 lekë/ litër vendos që të mos pranoj ofertën e “OLSI” Sh.p.k.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 26.04.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro